

Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant për administrator të universitetit.

I. KRITERET QË DUHET TË PLOTESOJË KANDIDATI PËR ADMINISTRATOR I UPT-së.

Kandidati për Administrator i Institucionit duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë arsim të lartë, të paktën në nivelin “Master i Shkencave” në fushën e drejtësisë ose ekonomisë;
- Të ketë jo më pak se 7 (shtatë) vite përvojë pune në këto fusha;
- Të ketë notë mesatare mbi 8 (tetë);
- Të mos jetë në ndjekje penale ose ndaj tyre është dhënë masë sigurimi personal;
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Të paraqesin kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Të paraqesin jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Të paraqesin fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Të paraqesin diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar;
5. Të paraqesin fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Të paraqesin vetë deklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Të paraqesin raport për vërtetimin e aftësisë në punë;
8. Të paraqesin vërtetim nga prokuroria që nuk janë në ndjekje penale;
9. Të paraqesin vërtetim të gjendjes gjyqësore;
10. Të paraqesin vërtetim që nuk kanë masa disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **20.05.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.